



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2016 – Numri: 190

Tiranë – E mërkurë, 12 tetor 2016

PËRMBAJTJA

	Faqe
Dekret i Presidentit nr. 9754, datë 7.10.2016	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 21005
Udhëzim i ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës nr. 3909/1, datë 4.10.2016	Mbi përcaktimin e kushteve, procedurave për ushtrimin e veprimtarive në ujërat detare nën juridiksionin e Republikës së Shqipërisë..... 21005
Kërkesë e Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës nr. 4828, datë 6.10.2016	Për shpronësim për interes publik të pasurive pronë private që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “By-pass Fier (shitesa)”, për pasuritë e llojit “truall” dhe “arë”..... 21008

**DEKRET****Nr. 9754, datë 7.10.2016****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c”, dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 9, pika 7, e nenit 20, të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998, “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar në propozimin e ministrit të Arsimit e Sportit,

DEKRETOJ:**Neni 1**

I jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tij personit të mëposhtëm:

Emir Bajram Sahiti.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**PRESIDENTI I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË**

Bujar Nishani

UDHËZIM**Nr. 3909/1, datë 4.10.2016****MBI PËRCAKTIMIN E KUSHTEVE,
PROCEDURAVE PËR USHTRIMIN E
VEPRIMTARIVE NË UJËRAT DETARE
NËN JURIDIKSIONIN E REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, ligjit nr. 9251, datë 8.7.2004, “Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, nenit 18, të ligjit nr. 10109, datë 2.4.2009, “Për administratën detare të Republikës së Shqipërisë”, ligjit nr. 10081, datë 23.2.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, vendimin nr. 538, datë 26.5.2009, të Këshillit të Ministrave, “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet QKL-së dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, të ndryshuar, me qëllim rregullimin e veprimtarisë së transportit kombëtar detar,

UDHËZOJ:

1. Përcaktimin e kushteve, procedurave për ushtrimin e veprimtarive detar në Republikën e Shqipërisë.

2. Objekti i udhëzimit është:

a) transporti kombëtar detar i personave dhe/ose mallrave me mjete lundruese, nga një port detar i Republikës së Shqipërisë drejtpërdrejt në një port tjetër detar të Republikës së Shqipërisë;

b) angazhimi, me anije, në ndonjë aktivitet tjetër të transportit detar të një natyre tregtare në ujërat shqiptare.

3. Përkufizimet për qëllimin e këtij udhëzimi në fushën e transportit detar, janë:

a) “Administrata detare”: është tërësia e strukturave të angazhuara në fushën e detarisë.

b) “Agjent detar”: është çdo person juridik/fizik i cili ka fituar një status të tillë pas regjistrimit në institucionet përkatëse dhe vepron si përfaqësues i pronarit ose operatorit të një mjeti lundrues në një port në lidhje me marrëdhëniet që pronari i mjetit lundrues krijon me autoritetet shtetërore dhe ato të shërbimeve në port. Agjenti detar nuk mund të kryejë shërbimin e tij në porte të tjera jashtë njesisë administrative ku është regjistruar si subjekt.

c) “Drejtoria e Përgjithshme Detare”: është autoriteti që drejton dhe organizon veprimtarinë e strukturave përbërëse të administratës detare, në zbatim të legjislacionit kombëtar dhe ndërkombëtar për fushën e detarisë, të ratifikuar me ligj nga Republika e Shqipërisë.

d) “E drejta e zhvillimit të veprimtarisë në transportin detar”: është e drejta që fiton një pronar ose operator mjeti lundrues për të kryer transport detar.

e) “Kodi Detar”: është ligji nr. 9251, datë 8.7.2004, “Kodit Detar të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;

f) “Licencë për ushtrim veprimtarie në fushën e transportit detar”: është akti administrativ që i njeh titullarit të saj të drejtën të fillojë dhe të ushtrojë veprimtarinë në transportin detar mbi bazën e procedurave dhe kërkesave të përcaktuara në këtë udhëzim;

g) “Ministri”: ministri përgjegjës për transportin detar;

h) “Ministria”: ministria përgjegjëse për transportin detar;



i) “Mjet lundrues”: është ai mjet lundrues i certifikuar nga shoqëritë klasifikuese përkatëse dhe është i aftë për të kryer një shërbim në transportin detar;

j) “Operim në linjë të rregullt për transport detar”: është veprimtaria që ushtrohet për transport detar me mjete lundruese të specializuara për kryerjen e një transporti të tillë, nga një port i hapur i Republikës së Shqipërisë drejt një porti tjetër të Republikës së Shqipërisë;

k) “Persona juridikë/fizikë në fushën e transportit detar”: janë persona të regjistruar si të tillë në qendrat kombëtare të regjistrimit me objekt veprimtarie sipas aktiviteteve në fushën e transportit detar;

l) “Pronar mjeti lundrues” është çdo person juridik/fizik që ka në pronësi ose me kontratë qiraje një ose më shumë mjete lundruese të llojeve të ndryshme;

m) “QKB”: Qendra Kombëtare e Biznesit;

n) “Transport i brendshëm detar”: është transporti që kryen një anije me flamur shqiptar ose të një shteti të Bashkimit Evropian, për qëllime tregtare, nga një port detar i Republikës së Shqipërisë në një port tjetër detar të Republikës së Shqipërisë ose në një vend tjetër brenda ujërave nën juridiksionin e Republikës së Shqipërisë.

4. Ky udhëzim zbatohet për veprimtaritë për qëllime tregtare që kryhen në ujërat detare nën juridiksionin e Republikës së Shqipërisë nga:

a) mjetet lundruese që kryejnë transport kombëtar pasagjerësh;

b) mjetet lundruese që kryejnë transport kombëtar mallrash;

c) mjetet lundruese që kryejnë shërbime portuale.

5. Mjetet lundruese, të parashikuara në pikën 4, gjerat “a” dhe “b” më lart, do të lundrojnë në zbatim të nenit 22 të Kodit Detar;

6. Mjetet lundruese, të parashikuara në pikën 4, gjerat “c” më lart, që do të kryejnë veprimtari detare të parashikuara në nenin 8, gjerat “b” dhe nenin 82 “Shërbime portuale” të Kodit Detar, duhet të jenë të regjistruar në Regjistrin e Mjeteve Lundruese Shqiptare dhe të mbajnë flamurin shqiptar.

7. Rregullorja nuk përfshin mjetet lundruese, si:

a) mjetet lundruese turistike dhe të kënaqësisë;

b) mjetet e peshkimit;

c) mjetet lundruese të destinuara vetëm për gara, duke përfshirë varkat me rrema për gara dhe varkat me rrema për trajnim, të etiketuara si të tilla nga prodhuesi;

d) mjetet lundruese sërfig, që përfshijnë ato me motor;

e) mjetet e angazhuar në operacionet e kërkim-shpëtimit;

f) mjetet e angazhuara në veprimtari në lidhje me emergjencat e ndotjeve detare apo ndonjë operacion tjetër;

g) mjetet e angazhuar në veprimtari kërkimore-shkencore e mbështetur në marrëdhënie dy- apo shumëpalëshe me shtetet fqinje;

8. Me qëllim lundrimin e sigurt, mjetet lundruese që do të lundrojnë në ujërat kombëtare duhet të kenë hartat e lundrimit për të përcaktuar pozicionin e saktë të anijeve, meqenëse mund të ndeshen në ujëra të cekëta e shkëmbinj nënujorë.

9. Zotëruesi i anijes është përgjegjës për të siguruar që të gjithë anëtarët e ekuipazhit të marrin trajnimin e duhur për detyrat që kanë marrë përsipër, si dhe të kuptojnë të gjitha rregullat përkatëse që mbulojnë sigurinë e lundrimit në dete.

10. Para se të jetë anëtar i ekuipazhit, çdo person i punësuar duhet të ketë njohuritë, trajnimet dhe udhëzimet e duhura për procedurat në bord. Kjo përfshin, por jo domosdoshmërisht kufizohet, me:

a) ankorimin dhe çakostimin;

b) lëshimin dhe kthimin e anijes së shpëtimit;

c) evakuimin nga të gjitha zonat e anijes;

d) veshjen e brezave të shpëtimit; dhe

e) përdorimin dhe transportimin e pajisjeve zjarrfikëse.

11. Trajnimi përkatës duhet, gjithashtu, të sigurohet për gjithë stafin e mjetit lundrues, në zbatim të Konventës STCW dhe akteve ligjore a nënligjore për zbatimin e kësaj konvente.

12. Anijet nuk lejohen të derdhen, shkarkojnë apo hedhin në det mbetjet me naftë ose vajra të krijuara gjatë lundrimit të anijes ose mbetjet shtëpiake, llumrat dhe mbetje të tjera të veçanta.

13. Anijet nuk lejohen të derdhen, shkarkojnë apo hedhin në det asnjë pjesë të mbetjeve të ngarkesës apo në lidhje me ngarkesën pa lejet përkatëse. Këtu përfshihen, gjithashtu, ambalazhimet dhe mjetet e sistemit.

14. Ujërat me mbetje shtëpiake nuk lejohen të shkarkohen apo të derdhen në det.



15. Ujërat e përdorura për shpëlarje nga hambari i anijes nuk lejohen të shkarkohen apo të derdhen në det.

16. Në rastin e shkarkimeve aksidentale të mbetjeve ose rrezikut të shkarkimit të tillë, kapiteni i anijes duhet të njoftojë pa vonesë autoritetet më të afërta kompetente, duke treguar në mënyrë sa më të saktë llojin, sasinë dhe pozicionin e shkarkimit.

17. Kapiteni i anijes duhet të sigurojë grumbullimin më vete në anije të mbetjeve me naftë dhe vajra që krijohen gjatë lundrimit të anijes në depozitat e vendosura për qëllimin dhe grumbullimin e ujit të shtrezës në shtrezat e sallës së motorëve. Depozitat duhet të ruhen në anije, në mënyrë të tillë që të dallohet dhe parandalohet në kohë çdo rrjedhje e përmbajtjeve përkatëse. Dorëzimi i mbetjeve në port bëhet tek operatorët e licencuar në zbatim të vendimit nr. 1104, datë 29.12.2015, “Për miratimin e kërkesave për parandalimin e shkarkimit të mbetjeve, të krijuara nga anijet dhe tepricat nga ngarkesat, në det”.

18. Gjatë kryerjes së transportit kombëtar, mjeteve lundruese nuk u lejohet:

a) përdorimi i cisternave të transportueshme të ruajtura në kuvertë për grumbullimin e mbeturinave të naftës;

b) djegia e mbeturinave në anije;

c) futja e agentëve pastrues emulsifikues ose tretës të graso në shtrezat e sallës së motorëve.

19. Kapiteni i anijes duhet të sigurojë grumbullimin më vete në anije dhe shpërndarjen në një impiant grumbullimi të mbetjeve, të tilla si: mbeturinat shtëpiake, llumrat dhe mbetje të tjera të veçanta. Sipas mundësisë, mbetjet shtëpiake duhet të depozitohen më vete sipas kategorive të mëposhtme: letër, qelq, lëndë të tjera të riciklueshme, si dhe mbetje të tjera dhe të dorëzohen në portin detar në zbatim të kuadrit ligjor për tërheqjen e mbetjeve nga anijet.

20. Të gjithë operatorët që kërkojnë të ushtrojnë aktivitetin e transportit kombëtar detar do të licencohen me licencë të kategorisë VII.4.1 në zbatim të ligjit nr. 10081, datë 23.2.2009, “Për licencat, lejet dhe autorizimet në Republikën e Shqipërisë” dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

21. Aplikimi për licencë për veprimtaritë parashikuar nga pika 4, gjerat “a” dhe “b” të këtij udhëzimi bëhet pranë QKB-së dhe duke zbatuar aktet nënligjore në fuqi.

22. Procedura për dhënien e lejes së kryerjes së veprimtarisë së parashikuar në pikën 4, germa “c” të këtij udhëzimi do të kryhet në zbatim të nenit 82 të Kodit Detar.

23. Të drejtën për dhënien e lejes për kryerjen e veprimtarisë së parashikuar në pikën 4, germa “c”, të këtij udhëzimi e ka ministri, në cilësinë e autoritetit më të lartë të administratës detare, sipas parashikimeve të nenit 5, të ligjit nr. 10109, “Për administratën detare të Republikës së Shqipërisë”. Ministri mund ta delegojë këtë të drejtë në përputhje me nenin 29 të Kodit të Procedurave Administrative.

24. Drejtoria e Përgjithshme Detare është institucioni përgjegjës për monitorimin e kryerjes së veprimtarisë së subjekteve që do të operojnë në përputhje me parashikimet e këtij udhëzimi.

25. Përfaqësuesi i DPD-së duhet të jetë prezent gjatë operacionit të ngarkimit të mallrave ose pasagjerëve për të kontribuar dhe kontrolluar sigurinë e operimeve.

26. Përfaqësuesi i DPD-së duhet të ketë pajisje të përshtatshme për të kontaktuar me shërbimet lokale të kërkimit dhe shpëtimit, portin detar, Policinë e Shtetit dhe organet e tjera që kanë interesa në port.

27. Zonat që duhet të kontrollohen nga përfaqësuesi i DPD-së janë zonat që lidhen kryesisht me çështje operationale, të tilla si: shmangia e mbingarkimit të anijes, kontrolli i numrit të pasagjerëve në anije, lloji i anijes, çdo gjendje apo situatë tjetër që mund të rrezikojë sigurinë e pasagjerëve, ndalimi i lundrimit të anijeve në kushte të këqija moti etj.

28. Kur personi i autorizuar beson me arsye të bindshme se një mjet lundrues, që kërkon të kryejë transport kombëtar, është në kundërshtim me dispozitat e këtij udhëzimi, ai mund të ndalojë mjetin lundrues dhe, me një urdhër, të kontrollojë anijen dhe ngrije asetet e gjetura në anije dhe të kërkojë dëshmi shtesë pasi beson me baza të arsyeshme se ka mospërputhje me këtë udhëzim.

29. Gjatë kryerjes së ndonjë prej detyrave sipas këtij neni, personi i autorizuar mundet, që:

a) të kërkojë nga pronari, kapiteni apo çdo person që mund të ketë në posedim ditar lundrimi zyrtar në anije apo ndonjë dokument, apo letër tjetër që mund të ofrojnë dëshmi të shkëljes, për ta paraqitur për inspektim ose për qëllime të marrjes së një kopje ose ekstrakte nga ditari i lundrimit, ose



ndonjë dokument, ose letër tjetër;

b) t'i kërkojë kapitenit të anijes dhënien e informacionit në lidhje me anijen, ngarkesat, magazinat, ekuipazhin, pasagjerët ose lundrimin sipas gjykimit të tij;

c) t'i kërkojë kapitenit apo cilitdo person të gjetur në bordin e anijes për të dhënë të gjithë ndihmën e arsyeshme në fuqinë e kapitenit ose çdo personi tjetër, sipas rastit, për të mundësuar personin e autorizuar për të kryer detyrat dhe funksionet e ngarkuara nga ky udhëzim; dhe

d) kur është e nevojshme të kërkojë ndihmën e Shërbimit Doganor Shqiptar, Rojës Bregdetare Shqiptare, Policisë Shqiptare dhe çdo zbatuesi tjetër të ligjit, të cilët i konsideron të nevojshëm.

30. Pavarësisht nga dispozitat e ligjeve tjera, asnjë leje nisje nuk do t'i jepet një anije të angazhuar në transportin detar të brendshëm bregdetare përveç rasteve kur pronari, çarteruesi, kapiteni ose agjenti i plotëson kërkesat e autoriteteve doganore ose autoriteteve të tilla të autorizuar për të lëshuar leje nisje që anija është licencuar për t'u angazhuar në transportin detar të brendshëm ose nëse ka përjashtimin e përcaktuar nga ky udhëzim.

31. Për qëllim të këtij udhëzimi të gjitha që kryejnë veprimtari në ujërat kombëtare janë subjekt i shkeljeve dhe kundërvajtjeve të listuara në Kodin Detar të Republikës së Shqipërisë, pjesa e tetë.

32. Licencat, përjashtimet, miratimet ose lejet e përmendura në këtë udhëzim, si edhe gjithë dokumentacioni i nevojshëm do të mbahen në bordin e anijes gjatë gjithë kohës së kryerjes së veprimtarisë.

33. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Politikave në Ministri dhe Drejtoria e Përgjithshme Detare.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas publikimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I TRANSPORTIT
DHE INFRASTRUKTURËS
Sokol Dervishaj

KËRKESË

Nr. 4828, datë 6.10.2016

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës shpall kërkesën “Për shpronësimet për interes publik, të pasurive pronë private që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “By-pass Fier (shtesa)”, për pasuritë e llojit “truall” dhe “arë”.

Subjekti kërkuar këtij objekti është Autoriteti Rrugor Shqiptar. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat, të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000, të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe përlogaritjes së masës së shpërblimit për pasuritë pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, i ndryshuar, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen, titullin e pronësisë apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës).

Ky publikim bëhet për pasuritë e llojit “truall” dhe “arë”. Pronarët do të kompensohen, për efekt shpronësimi, pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave dhe pasi të kenë paraqitur dokumentacionin respektiv të pronësisë pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar (subjekti kërkuar në bazë të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm, të pasurisë pronë private për interes publik”.

Vlera totale e shpronësimit është **66 168 047** (gjashtëdhjetë e gjashtë milionë e njëqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e dyzet e shtatë) lekë.

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM
I MINISTRISË SË TRANSPORTIT
DHE INFRASTRUKTURËS
Eduart Seitaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
SEKTORI I SHPRONËSIMEVE

LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN SI REZULTAT I NDËRTIMIT TË SEGMENTIT RRUGOR “BY-PASS FIER (SHITESA)

Nr.	PRONARI			Zona kad.	Numri i pasurisë	Lloji i pas.	ARË			TRUALL			Vlera totale (lekë)	Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri				Sip. shpron (m ²)	Çmimi (lekë/m ²)	Vlera (lekë)	Sip. shpron. (m ²)	Çmimi (lekë/m)	Vlera (lekë)		
1	Gramoz Mbarez	Shaban Dylber	Hajdarasi Hajdarasi	2636	31/ 8	Arë	29	269	7801				7801	Konfirmuar nga ZVRPP-ja-ja
2	Hurma	Hazis	Kalleshi +BP	2636	31/ 19	Arë	152	269	40888				40888	Konfirmuar nga ZVRPP-ja-ja
3	Mertiri		Tragjas	2636	31/ 21	Arë	191	269	51379				51379	Konfirmuar nga ZVRPP-ja-ja
4	Perparim	Hazis	Hysi	2636	31/ 11	Arë	138	269	37122				37122	Konfirmuar nga ZVRPP-ja-ja
5	Nurije	Riza	Hysi	2636	31/ 12	Arë	360	269	96840				96840	Konfirmuar nga ZVRPP-ja-ja
6	Shtet			2636	36/ 32	Arë	273	269	73437				73437	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
7	Stavro	Islam	Laska	2636	36/ 2	Arë	433	269	116477				116477	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
8	Zani	Nexhip	Buzi	2636	36/ 3	Arë	1001	269	269269				269269	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
9	Berti	Muhamrem	Laska	2636	36/ 4	Arë	814	269	218966				218966	Konfirmuar nga ZVRPP-ja-ja
10	Hille	Tom	Lleshi	2636	36/ 6	Arë	146	269	39274				39274	I pakonfirmuar
11	Mark	Ded	Malvataj	2636	36/ 7	Arë	61	269	16409				16409	I pakonfirmuar
12	Islam	Xhaferr	Kuci	2636	36/27	Arë	475	269	127775				127775	Konfirmuar nga ZVRPP-ja-ja
13	Baftjar	Hekuran	Buzi	2636	36/ 8	Arë	150	269	40350				40350	Konfirmuar nga ZVRPP-ja-ja
14	Abdulla	Ismail	Buzi	2636	36/ 9	Arë	75	269	20175				20175	Konfirmuar nga ZVRPP-ja-ja
15	Shpetim Dashnor	Nexhip,Zini	Licaj Licaj	2636 2636	72/61	Arë	392	269	105448				105448	Konfirmuar nga ZVRPP-ja-ja
16	Shtet			2636 2636	72/58	Arë	83	269	22327				22327	Konfirmuar nga ZVRPP-ja-ja
17	Faik	Mehmet	Veliu	2636	72/ 33	Arë	20	269	5380				5380	Konfirmuar nga ZVRPP-ja-ja
18	Idajet	Dervish	Veliu	2636	72/ 29	Arë	61	269	16409				16409	Konfirmuar nga ZVRPP-ja-ja
19	Idajet	Dervish	Veliu	2636	72/ 30	Arë	25	269	6725				6725	Konfirmuar nga ZVRPP-ja-ja
20	Merita	Gani	Arapi	2636	72/45	Truall				163	2390	389570	389570	Certifikatë pronësie
21	Luis	Dervish	Veliu	2636	72/ 36	Arë	55	269	14795				14795	Konfirmuar nga ZVRPP-ja-ja
22	Esat	Dervish	Veliu	2636	72/39	Arë	28	269	7532				7532	Konfirmuar nga ZVRPP-ja-ja
23	Sami	Dervish	Veliu	2636	72/ 7	Arë	132	269	35508				35508	Konfirmuar nga ZVRPP-ja-ja
24	Albert	Dervish	Veliu	2636	72/ 8	Arë	125	269	33625				33625	Konfirmuar nga ZVRPP-ja-ja
25	Idajet	Dervish	Veliu	2636	72/ 9	Arë	43	269	11567				11567	Konfirmuar nga ZVRPP-ja-ja
26	Idajet	Dervish	Veliu	2636	72/ 10	Arë	988	269	265772				265772	Konfirmuar nga ZVRPP-ja-ja
27	Rexhep	Sherif	Veliu	2636	72/ 11	Arë	98	269	26362				26362	Konfirmuar nga ZVRPP-ja-ja
28	Hamite	Myslym	Veliu	2636	72/52	Arë	91	269	24479				24479	I pakonfirmuar
29	Shtet			2636	72/ 58	Arë	992	269	266848				266848	Konfirmuar nga ZVRPP-ja-ja
30	Namik	Shaban	Veliu	2636	73/9	Arë	86	269	23134				23134	Konfirmuar nga ZVRPP-ja-ja
31	Rakip	Shaban	Veliu	2636	73/24	Arë	204	269	54876				54876	Konfirmuar nga ZVRPP-ja-ja
32	Faslli	Shaban	Veliu	2636	73/32	Arë	117	269	31473				31473	Konfirmuar nga ZVRPP-ja-ja



33	Faslli	Shaban	Veliu	2636	73/29	Arë	145	269	39005				39005	Konfirmuar nga ZVRPP-ja-ja
34	Reshat	Musa	Veliu	2636	73/12	Arë	137	269	36853				36853	Konfirmuar nga ZVRPP-ja-ja
35	Nikolla	Musa	Veliu	2636	73/16	Arë	670	269	180230				180230	I pakonfirmuar
36	Selim	Musa	Veliu	2636	73/14	Arë	803	269	216007				216007	Konfirmuar nga ZVRPP-ja-ja
37	Qamil	Shaqir	Veliu	2636	101/34	Arë	35	269	9415				9415	Konfirmuar nga ZVRPP-ja-ja
38	Fatmir	Xhevit	Veliu	2636	101/6	Arë	60	269	16140				16140	Konfirmuar nga ZVRPP-ja-ja
39	Barjam	Xhevit	Veliu	2636	101/4	Arë	176	269	47344				47344	Konfirmuar nga ZVRPP-ja-ja
40	Skender	Xhevit	Veliu	2636	101/5	Arë	113	269	30397				30397	Konfirmuar nga ZVRPP-ja-ja
41	Edlira Vjola Klei		Beqari Beqari Beqari	2636	100/1	Arë	284	269	76396				76396	Konfirmuar nga ZVRPP-ja-ja
42	Bektash	Pasho	Veliu	2636	100/2	Arë	290	269	78010				78010	Konfirmuar nga ZVRPP-ja-ja
43	Talibe	Xhelal	Veliu (+BP)	2636	100/3	Arë	264	269	71016				71016	Konfirmuar nga ZVRPP-ja-ja
44	Fiqiret	Misir	Veliu	2636	100/8	Arë	90	269	24210				24210	Konfirmuar nga ZVRPP-ja-ja
45	Ilirjan	Dalip	Veliu	2636	100/9	Arë	59	269	15871				15871	Konfirmuar nga ZVRPP-ja-ja
46	Bashkëpronësi			2636	121/4	Arë	748	269	201212				201212	Certifikatë pronësie
47	Kujtim	Isa	Fisheku	2636	128/60	Arë	76	269	20444				20444	I pakonfirmuar
48	Sabire	Arif	Gremi	2636	128/20	Arë	94	269	25286				25286	Konfirmuar nga ZVRPP-ja-ja
49	Sabire	Arif	Gremi	2636	128/21	Arë	155.6	269	41856.4				41856.4	Konfirmuar nga ZVRPP-ja-ja
50	Bajrush	Naim	Rakipi	2944	122/15	Arë	136	269	36584				36584	Konfirmuar nga ZVRPP-ja-ja
51	Xhemal	Nurçe	Ismaili	2944	122/16	Arë	41	269	11029				11029	Konfirmuar nga ZVRPP-ja-ja
52	Faslli	Jashar	Rakipi	2944	122/44	Arë	562	269	151178				151178	I pakonfirmuar
53	Sadik		Rakipi	2944	122/40	Arë	358	269	96302				96302	I pakonfirmuar
54	Shaban	Laze	Gjergaj	2944	131/1	Arë	120	269	32280				32280	Konfirmuar nga ZVRPP-ja-ja
55	Shtet			2944	131/2	Arë	337	269	90653				90653	I pakonfirmuar
56	Novruz	Riza	Malaj	2944	130/21	Arë	36	269	9684				9684	Konfirmuar nga ZVRPP-ja-ja
57	Asqeri	Hysni	Kaja	2944	130/6	Arë	33	269	8877				8877	Konfirmuar nga ZVRPP-ja-ja
58	Shtet			2944	130/9	Arë	1673.5	269	450171.5				450171.5	I pakonfirmuar
59	Kalem	Hysni	Kaja	2944	130/10	Arë	1060	269	285140				285140	Konfirmuar nga ZVRPP-ja-ja
60	Aleks		Kaja	2944	130/11	Arë	24	269	6456				6456	Konfirmuar nga ZVRPP-ja-ja
61	Shtet			2944	130/12	Arë	646	269	173774				173774	Konfirmuar nga ZVRPP-ja-ja
62	Ferit	Shaban	Demaj	2944	130/13	Arë	49	269	13181				13181	Konfirmuar nga ZVRPP-ja-ja
63	Barjam	Kaso	Alikaj	2944	130/14	Arë	127	269	34163				34163	Konfirmuar nga ZVRPP-ja-ja
64	Xhemal	Nurce	Ismaili	2944	130/15	Arë	34	269	9146				9146	Konfirmuar nga ZVRPP-ja-ja
65	Viron		Serjani	2944	129/23	Arë	18	269	4842				4842	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
66	Zenel	Yzeir	Sallaku	2944	129/25	Arë	11	269	2959				2959	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
67	Jakup	Yzeir	Sallaku	2944	129/58	Arë	25	269	6725				6725	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
68	Xhemal	Nurçe	Ismaili	2944	129/26	Arë	6	269	1614				1614	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
69	Sadik	Jashar	Rakipi	2944	129/103	Arë	9	269	2421				2421	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
70	Agron	Hysenj	Lika	2944	129/104	Arë	350	269	94150				94150	Certifikatë pronësie
71	Safet	Jashar	Rakipi	2944	129/28	Arë	9	269	2421				2421	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
72	Ramazan	Jashar	Rakipi	2944	129/29	Arë	46	269	12374				12374	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
73	Veli	Mersin	Rakipi	2944	129/30	Arë	20	269	5380				5380	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
74	Shkelqim	Veli	Rakipi	2944	129/84	Arë	25	269	6725				6725	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
75	Petrit	Tafil	Senka	2944	129/61	Arë	28	269	7532				7532	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
76	Haxhi	Mane	Senka	2944	129/34	Arë	36	269	9684				9684	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
77	Xhafer	Mane	Senka	2944	129/35	Arë	16	269	4304				4304	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
78	Mersin	Ramazan	Rakipi	2944	129/36	Arë	57	269	15333				15333	Konfirmuar nga ZVRPP-ja



79	Brahim	Jashar	Rakipi	2944	129/37	Arë	66	269	17754				17754	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
80	Mustafa	Mersin	Rakipi	2944	129/94	Arë	856	269	230264				230264	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
81	Tafil	Ramazan	Buzi	2944	129/39	Arë	88	269	23672				23672	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
82	Kadri	Gani	Crraga	2944	129/40	Arë	53	269	14257				14257	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
83	Gani	Sulo	Crraga	2944	129/42	Arë	80	269	21520				21520	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
84	Perparim	Refat	Crraga	2944	129/43	Arë	30	269	8070				8070	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
85	Kastriot		Metua (BP)	2944	129/44	Arë	73	269	19637				19637	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
86	Nazmi	Mysel	Metaj	2944	129/45	Arë	82	269	22058				22058	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
87	Musa	Hariz	Metua(BP.)	2944	129/82	Arë	92	269	24748				24748	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
88	Avni Gezim Xhevdet Musa		Meto Meto Meto Meto	2944	129/75	Arë	51	269	13719				13719	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
89	Jonuz	Myrtel	Metua (BP)	2944	129/71	Arë	50	269	13450				13450	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
90	Edmond	Jonuz	Meta	2944	129/49	Arë	55	269	14795				14795	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
91	Xhevdet	Hariz	Meta	2944	129/65	Arë	56	269	15064				15064	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
92	Petrit	Isa	Metaj	2944	129/69	Arë	150	269	40350				40350	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
93	Pellumb	Isa	Metaj	2944	129/66	Arë	131	269	35239				35239	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
94	Xhevit	Isa	Meta	2944	129/54	Arë	87	269	23403				23403	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
95	Feti	Sefer	Meta	2944	129/55	Arë	172	269	46268				46268	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
96	Novruz	Feti	Bushaj	1453	168/27	Arë	60	269	16140				16140	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
97	Novruz	Jaup	Halla	1453	168/22	Arë	60	269	16140				16140	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
98	Novruz	Feti	Bushaj	1453	167/51	Arë	71	269	19099				19099	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
99	Novruz	Jaup	Halla	1453	167/52	Arë	257	269	69133				69133	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
100	Nexhip	Haxhi	Halla	1453	167/53	Arë	163	269	43847				43847	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
101	Hajdar	Ramadan	Grembi	1453	166/56	Arë	288	269	77472				77472	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
102	Meçan	Rexhep	Gremi	1453	166/57	Arë	85	269	22865				22865	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
103	Besnik	Jonuz	Gremi	1453	166/58	Arë	72	269	19368				19368	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
104	Adem	Jonuz	Gremi	1453	166/59	Arë	54	269	14526				14526	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
105	Jonuz	Ram	Gremi	1453	166/60	Arë	131	269	35239				35239	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
106	Mynyr	Shefqet	Gremi	1453	166/88	Arë	152	269	40888				40888	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
107	Gramos Elena Rrenje Mynyr Naziko	Shefqet Shefqet Shefqet Shefqet Ismail	Grembi Tefiku Fasko Grembi Atija	1453	166/82	Arë	94	269	25286				25286	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
108	Nazif	Elmaz	Gremi	1453	166/84	Arë	100	269	26900				26900	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
109	Samedin	Elmaz	Gremi	1453	166/64	Arë	52	269	13988				13988	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
110	Fatmir	Elmas	Grembi	1453	166/94	Arë	43	269	11567				11567	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
111	Enver	Dalip	Gremi	1453	173/48	Arë	38	269	10222				10222	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
112	Piro	Miti	Pelani	1453	173/47	Arë	68	269	18292				18292	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
113	Dervish	Dalip	Gremi	1453	173/46	Arë	32	269	8608				8608	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
114	Artur	Dervish	Gremi	1453	173/45	Arë	16	269	4304				4304	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
115	Enver	Dalip	Gremi	1453	173/58	Arë	17	269	4573				4573	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
116	Petraq	Miti	Pelari	1453	173/43	Arë	11	269	2959				2959	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
117	Miti	Leksi	Pelari	1453	173/42	Arë	9	269	2421				2421	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
118	Vasil	Miti	Pelari	1453	173/41	Arë	9	269	2421				2421	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
119	Sokrat	Miti	Pelari	1453	173/40	Arë	13	269	3497				3497	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
120	Tefta	Krist	Sukulli	1453	173/29	Arë	26	269	6994				6994	Konfirmuar nga ZVRPP-ja



121	Miti	Leksi	Pelari	1453	174/28	Arë	26	269	6994			6994	I pakonfirmuar
122	Olimbi	Ziko	Pelari	1453	174/27	Arë	13	269	3497			3497	I pakonfirmuar
123	Lavdije Vezire Raif Luan Zamira	Qazim Muqerem Muqerem Muqerem Muqerem	Grembi Rukas Grembi Grembi Sulaj	3980	19/5	Arë	744	269	200136			200136	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
124	Bujar	Osmen	Grembi	3980	19/57	Arë	2888.5	269	777007			777006.5	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
125	Asllan	Osmen	Grembi	3980	19/58	Arë	1328.5	269	357367			357366.5	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
126	Asllan	Osmen	Grembi	3980	19/59	Arë	290	269	78010			78010	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
127	Skender	Osmen	Gremi	3980	19/2	Arë	7109	269	1912321			1912321	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
128	Dashamir Feruze Ramiz Resmi Shqiponja Shpetim	Jaup Mehmet Jaup Jaup Jaup Jaup	Dauti Dauti Dauti Dauti Dauti Dauti	3980 3980 3980 3980 3980 3980	19/77	Arë	3911	269	1052059			1052059	Certifikatë pronësie
129	Resmi	Jaup	Dauti	3980	19/71	Arë	1162	269	312578			312578	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
130	Ramiz	Jaup	Dauti	3980	19/78	Arë	1360	269	365840			365840	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
131	Andon	Jorgji	Cuko(BP)	3980	16/27	Arë	38	269	10222			10222	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
132	Kozma	Jorgji	Cuko	3980	16/25	Arë	107	269	28783			28783	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
133	Florant	Peço	Vasiu	3980	16/21	Arë	72	269	19368			19368	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
134	Martin	Peço	Vasiu	3980	16/22	Arë	87	269	23403			23403	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
135	Bledar	Peço	Vasiu	3980	16/23	Arë	58	269	15602			15602	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
136	Peco	Lluk	Vasiu(BP)	3980	16/24	Arë	70	269	18830			18830	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
137	Arqile	Vasil	Bane	3980	16/14	Arë	279	269	75051			75051	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
138	Marie		Ristani	3980	16/13	Arë	81	269	21789			21789	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
139	Drita		Ristani	3980	16/12	Arë	218	269	58642			58642	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
140	Xoxi	Kostandin	Cuko	3980	16/11	Arë	245	269	65905			65905	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
141	Todi	Kostandin	Cuko	3980	16/10	Arë	441	269	118629			118629	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
142	Riza	Cane	Cane	3980	16/19	Arë	151	269	40619			40619	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
143	Leksi	Kostandin	Cuko	3980	16/20	Arë	165	269	44385			44385	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
144	Arben	Ali	Xhoxha	3980	16/8	Arë	458	269	123202			123202	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
145	Izet	Ali	Xhoxha	3980	16/7	Arë	162	269	43578			43578	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
146	Shaban	Ali	Xhoxha	3980	16/6	Arë	324	269	87156			87156	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
147	Tajar	Fecor	Ferko	3980	16/5	Arë	169	269	45461			45461	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
148	Petref	Abaz	Ferko	3980	16/4	Arë	446	269	119974			119974	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
149	Qerime	Mustafa	Ferko	3980	16/3	Arë	59	269	15871			15871	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
150	Idriz	Abaz	Ferko	3980	16/2	Arë	214	269	57566			57566	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
151	Nadire Zabire Renardo Eglantina Elidjon	Ismail Kujtim Kujtim Kujtim Kujtim	Ferko Velaj Ferko Nestor Ferko	3980	16/1	Arë	932	269	250708			250708	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
152	Paskal	Kozma	Mefsha	3980	5/47	Arë	429	269	115401			115401	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
153	Harilla	Kozma	Mefsha	3980	5/46	Arë	96	269	25824			25824	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
154	Mikel	Kozma	Mefsha	3980	5/45	Arë	227	269	61063			61063	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
155	Kozma	Tasi	Mefsha	3980	5/44	Arë	153	269	41157			41157	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
156	Entela	Mina	Mefsha	3980	5/43	Arë	83	269	22327			22327	Konfirmuar nga ZVRPP-ja



	Artan	Mina	Mefsha										
157	Llazi	Ndoni	Andoni	3980	5/42	Arë	79	269	21251			21251	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
158	Llambi	Ndoni	Mefsha	3980	5/41	Arë	83	269	22327			22327	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
159	Sena		Mefsha	3980	5/40	Arë	122	269	32818			32818	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
160	Llamba	Spiro	Mefsha	3980	5/39	Arë	57	269	15333			15333	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
161	Nasi	Leko	Tasi	3980	5/38	Arë	80	269	21520			21520	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
162	Miti	Leko	Mefsha	3980	5/37	Arë	63	269	16947			16947	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
163	Llaqi	Petro	Mefsha	3980	5/36	Arë	310	269	83390			83390	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
164	Vasil	Petro	Petro	3980	5/35	Arë	235	269	63215			63215	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
165	Shpresa Lika Llaqi Zoica Gora Vasil Aristir	Petro Petro Petro Petro Petro Petro	Mefsha Foto Mefsha Como Dumi Petro Mefsha	3980	5/34,		99	269	26631			67716	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
166	Aristir	Petro	Mefsha	3980	5/33	Arë	80	269	21520			21520	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
167	Ndreke	Lili	Mefsha	3980	5/32	Arë	57	269	15333			15333	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
168	Sotir	Lili	Mine	3980	5/31	Arë	59	269	15871			15871	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
169	Argile	Thoma	Gjini	3980	5/30	Arë	29	269	7801			7801	I pakonfirmuar
170	Luljeta Dhimiter Vangjelia Elvira	Luljeta Dhimiter Vangjelia Elvira	Hajdini Bitri Kole Ristani	3980	5/29	Arë	158	269	42502			42502	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
171	Dhimiter	Llambi	Bitri	3980	5/28	Arë	79	269	21251			21251	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
172	Vilson	Lako	Kostandini	3980	5/27	Arë	134	269	36046			36046	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
173	Marije		Kostandini	3980	5/26	Arë	111	269	29859			29859	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
174	Mimoza	Jorgji	Bullgari	3980	5/25	Arë	60	269	16140			16140	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
175	Vida	Spiro	Kostandini	3980	5/24	Arë	49	269	13181			13181	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
176	Novrus	Demir	Merko	3980	5/54,	Arë	3800	269	1022200			1022200	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
177	Todi	Leksi	Prendi	3980	5/3	Arë	276	269	74244			74244	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
178	Novruz	Nexhmedin	Myrto	3980	4/3	Arë	766	269	206054			206054	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
179	Myqerem	Zani	Merko	3980	4/5,	Arë	5351	269	1439419			1439419	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
180	Kristaq	Nasi	Zhezha	3980	4/2	Arë	1477	269	397313			397313	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
181	Dilaver	Elez	Qelia	3980	5/50	Arë	200	269	53800			53800	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
182	Xhezmi	Zenel	Velcani	3980	5/51	Arë	576	269	154944			154944	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
183	Qazim	Ramadan	Merko	3980	4/4,	Arë	1369	269	368261			368261	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
184	Vangjel	Fani	Byzyka	3980	3/43,	Arë	1940	269	521860			521860	I pakonfirmuar
185	Shaqe Bukuri Sami Faïre Murat Marge Reshat Ganimete	Xhelal Xhelal Xhelal Xhelal Xhelal Xhelal Xhelal	Kazanxhi Taço Murati Shaçma Murati Murati Murati	1091	110/4	Arë	1655	269	445195			445195	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
186	Azbi	Veiz	Veizi	1091	111/10	Arë	280	269	75320			75320	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
187	Pelivan	Haziz	Koci	1091	111/9	Arë	133	269	35777			35777	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
188	Nexhip	Qamil	Sacma	1091	111/8	Arë	493	269	132617			132617	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
189	Them	Vangjel	Toska	1091	111/6	Arë	366	269	98454			98454	Konfirmuar nga ZVRPP-ja



190	Besnik	Hajro	Reshlani	1091	111/4	Arë	283	269	76127			76127	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
191	Zenel	Hajdin	Reshlani	1091	111/3	Arë	438	269	117822			117822	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
192	Ilmi	Hajdin	Reshlani	1091	111/2	Arë	859	269	231071			231071	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
193	Sadik	Hajdar	Breshnica	1928	264/23	Arë	104	269	27976			27976	I pakonfirmuar
194	Feriz	Hajdar	Breshnica	1928	264/28	Arë	459	269	123471			123471	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
195	Muhamet	Hasan	Stojku	1928	264/26	Arë	423	269	113787			113787	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
196	Hasan	Uke	Cuni	1928	264/4	Arë	175	269	47075			47075	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
197	Qerim	Uke	Curri	1928	267/1	Arë	829	269	223001			223001	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
198	Qerim	Uke	Curri	1928	267/10	Arë	1466	269	394354			394354	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
199	Shtet			1928	267/11	Arë	549	269	147681			147681	I pakonfirmuar
200	Fatmir	Osmen	Kuka	1928	267/12	Arë	644	269	173236			173236	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
201	Agim	Seit	Adili	1928	266/2	Arë	1057	269	284333			284333	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
202	Idriz	Seit	Adili (BP)	1928	266/10	Arë	526	269	141494			141494	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
203	Shtet			1928	264/ 22	Arë	1499	269	403231			403231	I pakonfirmuar
